

Sezoni veror, 370 mijë udhëtarë dhe 84 mijë autovetura me tragete.

01.09.2011

---



Afro 370 mijë udhëtarë kanë preferuar të lundrojnë me tragete gjatë këtij sezoni veror. Megjithëse nuk ka përfunduar ende kthimi masiv i bashkatdhetarëve që kaluan pushimet pranë familjeve të tyre në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni të dhënat paraprake të Autoritetit portual bëjnë me dije se që nga fillimi i muajit qershor tragetet e linjave kanë kryer 512 lundrime drejt porteve të Barit, Ankonës dhe Triestes dhe po kaq të tjera nga Italia në drejtim të Shqipërisë.

Gushti ka qenë muaji më i ngarkuar i kësaj periudhe me afro 85 mijë udhëtarë në mbërritje dhe më shumë se 126 mijë të tjerë që u larguan drejt vendeve të Evropës perëndimore.

Gjatë kësaj vere ka patur vonesa shumë të vogla në përpunimin e udhëtarëve dhe në nisjen e trageteve, pasojë e bashkëpunimit real të të gjitha institucioneve që operojnë në hapësirën portuale. Përveç sheshit perëndimor të terminalit këtë verë u vu në dispozicion për autoveturat edhe sheshi qendror i portit, nga ku mjetet të sinjalizuara më parë nisen drejt trageteve përkatëse.

Pikat e kontrollit kufitar dhe doganor për automjetet dhe këmbësorët gjatë këtij sezoni janë dyfishuar, duke arritur deri në 35 të tilla në rastet e mbingarkesës.

Gjatë tremujorit qershor-gusht të këtij viti tragetet kanë transportuar në drejtimet vajtje-ardhje 15.612 kamjonë dhe trajlera.

